

FUQIZIMI I SHOQËRISË CIVILE

Drejt një qeverisje të mirë dhe zhvillim



Shoqëria civile në Shqipëri gjithmonë se më tepër ka patur tendencën për t'u orientuar nga prioritetet e donatorëve. Kjo shpesh duke u distancuar nga qytetarët, nevojat dhe prioritetet e tyre në kontekstin lokal. Një situatë e tillë ka shkaktuar një ambjent të vështirë për zhvillimin e shoqërisë civile. Në këtë kuadër, pjesëmarrja qytetare dhe mbi të gjitha roli më aktiv i shoqërisë civile, vazhdon të jetë problematike, në veçanti në zonat rurale e periferike. Në këtë kontekst IDM në bashkëpunim

OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

- Ndërtimi i kapaciteteve të qëndrueshme për shoqërinë civile rurale si aktor kyç në zhvillimin e prioritetëve të komuniteteve lokale nëpërmjet aksioneve konkrete.
- Sensibilizimi dhe advokimi me vendim-marrësit në nivel kombëtar dhe lokal, në dobi të zhvillimit të alternativave në krijimin e partneriteteve komunitet - biznes - qeverisje.

me PNUD-in ka nisur implementimin e projektit "Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike". Projekti, 18 mujor, shënon një nga iniciativat e shumta të mbështetura nga PNUD për forcimin e shoqërisë civile në Shqipëri. PNUD mbështet aspiratat e Shqipërisë për integrimin në Bashkimin Europian dhe

ndihmon në përpjekjet e vendit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM). Ky projekt vjen edhe si vijimësi e iniciativës së mëparshme të mbështetur po nga PNUD – "Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë (2010)" i cili bëri një vlerësim gjithëpërfshirës të sektorit të tretë, bazuar në një metodologji globale, duke identifikuar një sërë problematikash dhe sfidash. Projekti fillimisht do të vlerësojë aktorët kryesorë të shoqërisë civile në të katër qarqet, Lezhë, Elbasan, Gjirokastrë e Berat. Përgatitja e kapaciteteve të organizatave vendore të shoqërisë civile dhe zhvillimi i prioritetëve në rajonet që ato operojnë, përbëjnë komponentët kryesorë të këtij projekti. Një fokus i veçantë do t'i kushtohet forcimit të principeve themelore të shoqërisë civile rurale si transparencës, përgjegjshmërisë, gjithpërfshirjes etj.

"Revista Komunitare"

Një dritare drejt Komunitetit

"Revista Komunitare" është një botim i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në kuadër të projektit "Forcimi i Kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike", e mbështetur nga PNUD. Kjo Revistë periodike do të botohet çdo 3 muaj dhe do të përmbajë përveç aktivitetëve në kuadër të këtij projekti, edhe informacion mbi situatën dhe perspektivat e shoqërisë civile në rajone të ndryshme të Shqipërisë. Revista ka si qëllim që jo vetëm të bëhet një dritare komunikimi mes publikut dhe organizatave të shoqërisë civile, por në të njëjtën kohë ti japë edhe zë këtyre të fundit, mbi problemet, vështirësitë që ato përballen. Kjo revistë synon të bëhet një platformë informacioni dhe komunikimi mes aktorëve të ndryshëm si institucione publike, organizata jo-qeveritare, biznese apo komunitete.

Në brendësi...

Lezha: Drejt një Zhvillimi Rural të Qëndrueshëm.....	2
Profil Organizate	2
Kultivimi i Simbolit të Pagues	3
Federata Rajonale e Pyjeve.....	3
Fermerët maqedonas gjejnë zërin e tyre	3
Komiteti Evropian për Trajnim dhe Bujqësi (CEFA)	4
Aktivitetet në vazhdim	4

Aktivitete

Vlerësimi i Shoqërisë Civile në Zonat Rurale e Periferike

Projekti "Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike" është në hapat e saj fillestarë. Tremujori i parë i projektit fokusohet në një vlerësim të kujdesshëm të situatës së shoqërisë civile në zonat rurale dhe nevojave të aktorëve të saj në këto zona. Me këtë synim, IDM ka ngritur një skuadër ekspertësh, e cila gjatë muajve gusht-tetor hartuan metodologjinë, si dhe vazhduan me mbledhjen e të dhënave në terren duke i analizuar. Të dhënat u përkthyen në një raport vlerësi-



mi, i cili para se të publikohet, do të ndahet dhe konsultohet me vetë përfaqësues të shoqërisë civile të zonave rurale me qëllim validimin e gjetjeve të misionit vlerësues. Pjesë e këtij vlerësimi kanë qenë qarqet Lezhë, Elbasan, Berat dhe Gjirokastrë. Intervista të thelluara me persona kyç si dhe pyetësorë me përfaqësues të shoqërisë civile, sektorit privat dhe pushtetit vendor u realizuan në zonat rurale dhe ato suburbane të këtyre qarqeve.



Lezha: Sfidat e Zhvillimit të Qëndrueshëm



Qarku i Lezhës ka qenë një zonë me ekonomi kryesisht industriale (miniera, industri ushqimore, kimike) dhe bujqësore deri në fillim të viteve 1990. Me fillimin e proceseve demokratike Qarku i Lezhës filloi të përballlet me sfida të mëdha nga pikëpamja e transformimit drejt një ekonomie të hapur tregu, e cila

në ditët e sotme është e përqendruar kryesisht në industrinë e materialeve dhe aktiviteteve të ndërtimit, bujqësi dhe peshkim. Pavarësisht progresit dhe zhvillimit, Qarku i Lezhës ka aktualisht një nivel relativisht të lartë papunësie prej rreth 24.2%, rreth 10.7% më shumë se niveli mesatar i papunësisë në shkallë

Problematika

Disa prej problemeve thelbësore të identifikuar në Qarkun e Lezhës janë mungesa e qendrave rinore, infrastruktura e marketingu i dobët, mosdergjegjesim i qytetarëve, mosaktivizim i rinisë në dhënien e ideve, mungesë e njerëzve të specializuar në administratë, mungesë e metodave motivuese në mësimdhënie, mungesë e aktiviteteve kulturore, mos-shfrytëzimi i duhur i burimeve natyrore, kaos urban, keqmenaxhimi i fondeve publike, ndotja e mjedisit, mos-shfrytëzimi i zonës industriale, mungesë e politikave afatgjatë, mungesë planifikimi, mungesë bashkëpunimi, shpyllëzimi.

kombëtare. Në territorin e qarkut operojnë rreth 2.978 kompani private, nga të cilat thuajse 85% janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM). Duke pasur parasysh nivelet aktuale të mundësive për punësim të ofruara, është e rëndësishme të nxirret në pah pikërisht potenciali për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik i Qarkut të Lezhës

...drejt një qeverisjeje më gjithpërfshirëse

Përmirësimi dhe konsolidimi i bashkëpunimit dhe ndarjes së përgjegjësisë, do të përfshijnë jo vetëm kapacitetet dhe resurset e brendshme të rajonit, por gjithashtu edhe aktorët e tjerë të rëndësishëm në nivel kombëtar...

Një ndër prioritetet kryesore në qarkun e Lezhës, ka të bëjë me rolin e aktorëve publikë rajonalë – Këshilli i Qarkut dhe autoritetet vendore – marrëdhënien e tyre me komunitetin, aktorët e rëndësishëm rajonalë, partnerët në rajonet fqinje dhe roli si lider i politikave të zhvillimit socio-ekonomik rajonal. Një numër i konsiderueshëm programesh të asistencës për qeverisjen vendore kanë vendosur në qendër të mbështetjes së tyre pikërisht këto ndërveprime dhe praktika të qeverisjes së mirë, të cilat konsiderohen në vizionin e Këshillit të Qarkut si thelbësore për rezultate të qëndrueshme. Ndarja e



përgjegjësisë, përpjekjeve dhe e resurseve në funksion të tyre, nën një përjasje gjithëpërfshirëse, e cila mbështetet tek një mori ndërveprimesh mes aktorëve brenda dhe jashtë rajonit, përbën një komponent të cilit do t'i kushtohet vëmendje në vazhdimësi.


Profil Organizate

Federata Bujqësore Elbasan

Suksese dhe Sfida

Federata Bujqësore Elbasan (FBE) është themeluar në vitin 2007 me mbështetjen e një projekti të Ko-operacionit Italian dhe me pas është regjistruar si Shoqëri e Bashkëpunimit Reciprok. FBE përbëhet nga tre shoqata (federata) të kultivuesve të ullirit: "Ulli Dumrea" që vepron në zonën e Dumresë, Ulli "Gostima" përqendruar në komunat Gostimë, Klos dhe Mollas dhe një tjetër shoqatë për prodhimin e Ullirit

në komunat Shirgjan dhe Gjinar. Brenda FBE-së përfshihet dhe Shoqata e Shërbimeve Bujqësore (ShBE) e cila merret kryesisht me asistencën teknike në bujqësi dhe blegtori. Shoqatat përbërëse të FBE-së kanë 383 anëtarë të cilët kultivojnë rreth 15,500 rrënjë ullinj. Në sajë edhe të ndihmës nga donatorët Italiane, në zonat përkatëse ekzistojnë tre kooperativa për bluarjen e ullirit. Vaji i prodhuar shitet



nën markën "Valmi". Gjithashtu ekzistojnë evidenca që tregojnë se një pjesë e vajit të prodhuar shitet edhe në Itali.



Kultivimi i simbolit të pages

Dikur, Mali i Zi me 450,000 pemët të llirit ishte furnizuesi kryesor me vaj ulliri për Ish-Jugosllavinë. Shpërbërja e Jugosllavisë, sanksionet ekonomike dhe izolimi shkaktuan vështirësi në industrinë e vajit të ullirit. Për më shumë se një dekadë kultivuesit e ullirit u harruan, korrja kry-



hej në mënyrë manuale kryesisht duke mbledhur kokrrat e ullirit pasi binin në tokë dhe fermerët shisnin produktet e tyre me ambalazh të pa etiketuar.

Sot janë ndërmarrë një sërë projektesh për rigjallërimin e industrisë së vajit të ullirit falë mbështetjes së programit të USAID-it: Rigjallërimi i Komunitetit me anë të Veprimit Demokratik që u zbatua nga International Relief and Development (IRD) në jug të Malit të Zi. Këto projekte po ndryshojnë jetët

Rigjallërimi i industrisë së vajit në Malin e Zi



e fermerëve të ullirit dhe po krijojnë kushtet për suksesin e Malit të Zi në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare të Ullirit. Pas këtyre investimeve fillestare,

USAID financoi një fabrikë të përpunimit të Ullirit në

Mrkojevici (Bar), si dhe mundësoi pajisjet për përmirësimin e kontrollit të cilësisë së vajit për Institutin për Bimësinë Sub-Tropikale të

Barit. Investimet sollën një rritje të trefishit të prodhimit të vajit të ullirit.

Fermerët maqedonas gjejnë zërin e tyre



Kur SIDA ngarkoi Federatën e Fermerëve të Suedisë (FFS) me detyrën për të mbështetur formimin e një organizate kombëtare të fermerëve Maqedonas në vitin 2001, ekzistonte mosbesim ndërmjet fermerëve maqedonas me etni të ndryshme. Por bashkëpunimi mes tyre është rritur ndjeshëm ndërkohë që Federata e Fermerëve e Republikës së

Maqedonisë (FFRM) negocion me qeverinë për polika më cilësore. Përveç vendosjes së bashkëpunimit ndërmjet fermerëve të etnive të ndryshme, nevojitej gjithashtu që fermerët të rritnin prodhimin e tyre si dhe të arinin ta shisnin atë. Me formimin e FFRM-së

u prezantuan një sërë praktikash ko-operativash dhe bashkëpunimi ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve. Ky bashkëpunim është i nevojshëm, duke qenë se maqedonasit posedojnë ferma me prodhim të ulët. Pavarësisht problemeve ndër-etnike, krijimi i FFRM-së ka kontribuar dukshëm për uljen e tensioneve.


"Parësisht problemeve ndër-etnike, krijimi i Federatës së Fermerëve të Maqedonisë ka kontribuar dukshëm për uljen e tensioneve në vend..."

Mbi të gjitha fermerët kanë një shoqatë që mbron interesat e tyre dhe që u mundëson atyre të marrin pjesë si palë negociuese në procesin zyrtar vendim-marrës. Kjo përbën një sukses dhe një veçanti për rajonin. "Nuk ka diçka të ngjashme në Ballkanin e sotëm dhe fqinjët e shohin si një model për t'u ndjekur." shprehet kordinatorja suedeze Lundin.

Federata Rajonale e Pyjeve e Kullotave

Aleanca për një zhvillim të qëndrueshëm

Transferimi i pyjeve dhe kullotave komunale drejt komunave në Shqipëri ka nisur në vitin 1996 bazuar në prioritetet e qeverisë për rritjen e decentralizimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave. Në kuadër të kësaj nisme, bashkimi i shoqatave në tre komunat e qarkut Elbasan u bashkuan për t'u bërë pjesë e rrjetit të Federatave Rajonale të Përdorimit të Pyjeve dhe Kullotave Komunale (FRPPKK). Një iniciativë e suksesshme ndërmarrë nga Shoqatat për Përdorimin e Pyjeve



dhe Kullotave Komunale (ShPPKK) me mbështetjen financiare të Bankës Botërore është rehabilitimi i pyjeve të Dumresë.

Projekti po zbatohet nga 15 ShPPKK të komunës Grekan në bashkëpunim me autoritetet vendore, specialistë të pyjeve dhe komunitetin. Projekti ka përfshirë rehabilitimin e 600 ha pyjeve dhe sensibilizimin e komunitetit për mos dëmtimin e tyre si dhe ngritjen e një projekti eksperimental për trajtimin e cungishtave të Dushkut për t'i shndërruar ato në pyje të larta në perspektivë. Nga matjet e realizuara në vitin 2005, rezultonte një rritje vjetore prej 7 m3 për hektarë.



“Strategjia e Shoqërisë Civile”

TAKIME KONSULTATIVE



Me finalizimin e vlerësimit paraprak të sfidave dhe nevojave të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike, IDM në bashkërendim me PNUD Shqipëri dhe partnerët lokalë në të katër qarqet e përzgjedhur, do të organizojnë një seri takimesh konsultative (dis-

kutime në grupe të fokusuar) mbi gjetjet paraprake të vlerësimit. Synimi i këtij aktiviteti është të saktësohen konkluzionet paraprake të vlerësimit, nën një përfaqëse sa më gjithëpërfshirëse me aktorë lokalë dhe përfaqësues të tjerë nga sektori publik, privat dhe civil në zonat e targetuara. Këto konsultime do të jenë thelbësore gjithashtu edhe për hapin pasardhës – hartimi i një draft-strategjie për veprim në funksion të rivitalizimit të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike, e cila do të diskutohet më tej në një workshop kombëtar.

Angazhimi Qytetar ...



ÇELËSI DREJT NJË QEVERISJE TË MIRË QËNDRON TEK TË GJITHË NE

Workshopi Kombëtar – Për një shoqëri civile aktive

Workshop-i Kombëtar do të zhvillohet me pjesëmarrjen e gjerë të përfaqësuesve të komuniteteve, shoqërisë civile dhe qeverisjes vendore. Ai synon të mbledhë në një forum diskutimesh aktorë dhe përfaqësues të rëndësishëm të institucioneve të ndryshme në nivel vendor dhe kombëtar mbi vlerësimin dhe planin e propozuar për veprim në mbështetje të shoqërisë civile në zonat rurale dhe

periferike. Synimi i këtij aktiviteti është të ofrojë hapësirë e nevojshme për ndërveprim mes përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe komuniteteve vendore dhe aktorëve të tjerë (kombëtarë ose lokalë) me ndikim ose potencial për të ndikuar pozitivisht në rritjen e aktivizimit dhe aksionit të shoqërisë civile përtej qendrave urbane.

Kontributi i këtij workshop-i do të reflektohet në raportin final të vlerësimit, i cili do të printohet dhe shpërndahet më tej me aktorë vendas dhe të huaj që operojnë në Shqipëri. Paralelisht me këto përpjekje, grupi i ekspertëve të IDM dhe stafi i projektit do të



ndërmarrin përgatitjet e nevojshme për fillimin e një fushate ndërgjegjësimi për publikun, me synim nxitjen e aksionit të qytetarëve, rigjallërimin e shoqërisë civile në zonat e targetuara si edhe hartimin e një Kodi të Etikës së Shoqërisë Civile në këto zona.



Komiteti Evropian për Trajnim dhe Bujqësi (CEFA)

Komiteti Evropian për Trajnim dhe Bujqësi (CEFA) është një organizatë europiane, e formuar në vitin 1971. Ajo është aktive në Itali, në vende të tjera të Evropës Lindore, në Amerikën Latine dhe në rajone të Afrikës. CEFA synon të zbatojë programet e zhvillimit të qëndrueshëm vendor në fusha të tilla si: agrikultura, zooteknika, kujdesi shëndetësor, energjetika dhe mjedisi, sistemet e ujerave, trajnimet dhe jetën shoqërore duke ushqyer vetëbesimin dhe duke iu përgjigjur kërkesave baze të popullsisë. Në Shqipëri, CEFA është aktive që në vitin 1991 sidomos në Qarkun e Elbasanit (1998). Në vitin 2002 CEFA ndihmoi dhe mbështeti krijimin e dy OJF-ve në qarkun Elbasan: Shërbimet Bujqësore Elbasan (ShBE) në fushën agrare dhe zooteknike dhe Tjetër Vizion për fushën sociale. Fuqizimi i këtyre shoqatave është një nga objektivat kryesore të CEFA-s për të garantuar një të ardhme të qëndrueshme për punën që ajo ka kryer gjatë 14 viteve të fundit në Elbasan.